

Vendim nr. 163 datë 12.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 12.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (I) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ISUF DULO DULAJ *alias* ILIR BREGU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 572, datë 23.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 34, datë 23.01.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2022-1797, datë 22.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga materialet e çështjes konkrete ka rezultuar se kërkuesi Isuf Dulo Dulaj (*kërkuesi*) është shpallur fajtor dhe dënuar nga gjykatat italiane për kryerjen e tri veprave penale.

Konkretisht: (i) -me vendimin nr. 445, datë 26.04.2005 të Gjykatës së Arezzos (Itali) është deklaruar fajtor dhe dënuar me 4 (katër) muaj burgim për kryerjen e veprës penale “Largimi nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm”, të parashikuar nga neni 385 i Kodit Penal italian; (ii) - me vendimin nr. 899, datë 13.03.2009 të Gjykatës së Apelit Firenze (Itali) është deklaruar fajtor dhe dënuar me 2 (dy) vjet e 10 (dhjetë) muaj e 20 (njëzet) ditë burgim, për kryerjen e veprës penale “Prodhimi, trafikimi dhe mbajtja e paligjshme e lëndëve narkotike ose psikotrope”, të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian dhe dekreti nr. 309/90 i Presidentit të Republikës së Italisë; (iii) - me vendimin nr. 2821, datë 07.10.2013 të Gjykatës së Apelit Firenze (Itali) është deklaruar fajtor dhe dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim për kryerjen e veprave penale “Pengmarrja”, si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuar nga neni 605 i Kodit Penal italian dhe nenet 10, 14 të ligjit nr. 497/74.

2. Në vijim, Gjykata e Apelit Firenze (Itali), me vendimin nr. 211/2014, ka vendosur bashkimin e dënimeve penale të dhëna përmes 3 (tre) vendimeve gjyqësore të formës së prerë (të sipërcituara), duke e dënuar përfundimisht kërkuesin me 8 (tetë) vjet e 10 (dhjetë) muaj burgim për kryerjen e veprave penale “Pengmarrja”, “Armëmbajtja pa leje” dhe “Trafikimi i lëndëve narkotike”, të parashikuara nga nenet 81, 110 dhe 605 të Kodit Penal italian. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Firenze (Itali) ka nxjerrë urdhërarrestin ndërkombëtar për kërkuesin, me qëllim dorëzimin përpara autoriteteve të drejtësisë italiane për ekzekutimin e vendimit.

3. Nga materialet e dosjes rezulton se kërkuesi është arrestuar në datën 16.05.2017 nga organet e policisë së qytetit të Vlorës. Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, me anë të shkresës nr. 4601 prot., datë 17.05.2017, i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë materialet në lidhje me ekzekutimin e urdhërarrestit ndërkombëtar. Në vijim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, referuar neneve 493 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesë për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg” ndaj kërkuesit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 151, datë 18.05.2017, ka pranuar kërkesën, duke caktuar masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg” me afat 40 ditë ndaj kërkuesit, në ekzekutim të urdhërarrestit ndërkombëtar.

5. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, përmes shkresës nr. 1961/1 prot., datë 12.06.2017, i ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, kërkesën e ardhur nga Ministria e Drejtësisë së Italisë,

në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të dhënë nga Gjykata e Apelit të Firenzes (Itali) ndaj kërkuessit.

6. Masa shtrënguese “Arresti në burg” e dhënë për efekt të ekzekutimit të arrestit ndërkombëtar kishte efekte të përkohshme, deri në datën 27.06.2016 dhe kushtëzohej nga paraqitja e kërkesës për ekstradim, e cila tashmë ishte ndryshuar, duke u paraqitur një kërkesë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të dhënë nga Gjykata e Apelit të Firenzes (Itali). Për këtë arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në datën 23.06.2017, pas marrjes së akteve nga Prokuroria e Përgjithshme (të përcjella përmes Ministrisë së Drejtësisë), ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesë për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, për efekt të njohjes dhe ekzekutimit të vendimit penal italian në ngarkim të kërkuessit.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 199, datë 23.06.2017, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg” ndaj kërkuessit, për efekt të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve penale të dhëna nga gjykatat italiane në ngarkim të tij.

8. Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 11.07.2017 ka paraqitur kërkesën në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale në ngarkim të kërkuessit dhe konvertimin e dënimit duke kërkuar për kërkuessin një dënim të vetëm në masën 9 (nëntë) vjet, 10 (dhjetë) muaj e 20 (njëzet) ditë burgim, duke zbritur nga kjo masë dënimi, periudhën e dënimit të vuajtur në shtetin italian në masën 1(një) vit e 2 (dy) ditë burgim.

9. Pas kërkesës së prokurorisë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 572 datë 23.10.2017. ka vendosur, në mënyrë të përmblodhur, njohjen e të tre vendimeve penale të huaja, duke i konvertuar dënimet për secilën vepër penale. Në përfundim, ka vendosur bashkimin e dënimeve të dhëna për kërkuessin në një dënim të vetëm, në masën 8 (tetë) vjet, 10 (dhjetë) muaj e 20 (njëzetë) ditë burgim, vuajtja e të cilit do të fillonte nga data e arrestimit të kërkuessit dhe në llogaritjen e pjesës së vuajtur të dënimit do të përllogaritej edhe koha e paraburgimit e vuajtur në shtetin italian, si dhe koha e paraburgimit të vuajtur në shtetin shqiptar, për efekt të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit të vendimit penal të huaj.

10. Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuessi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 572 datë 23.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

11. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 34, datë 23.01.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 572, datë 23.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

12. Kundër vendimit nr. 34, datë 23.01.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs kërkuesi i përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2022-1797, datë 22.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së.

13. Kërkuesi, i cili aktualisht ndodhet në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier (*IEVP*), në datën 25.05.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuesit

14. **Kërkuesi** në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

14.1. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi kërkuesi nuk është njohur me akuzat dhe nisjen e procedimit penal të zhvilluar ndaj tij në shtetin italian dhe të përfunduar me vendimin nr. 2821, datë 07.10.2013 të Gjykatës së Firenzes (Itali). Gjatë gjykimit të çështjes si organet gjyqësore italiane, ashtu edhe ato shqiptare nuk kanë provuar marrjen dijeni të kërkuesit për procedimin penal, gjykimin dhe dënimin e tij nga gjykatat italiane.

14.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, pasi kërkuesi nuk ka pasur dijeni për procesin e zhvilluar në ngarkim të tij dhe nuk i është krijuar mundësia për të përgatitur mbrojtjen nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij, si gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale. Ai nuk është dëgjuar në lidhje me akuzat gjatë procesit gjyqësor penal të zhvilluar në ngarkim të tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik

ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimit të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor penal të zhvilluar në gjykatat italiane, për rrjedhojë edhe në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat shqiptare me objekt njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, gjatë të cilit janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi.

17. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit, duke parashtruar përpara tyre pretendimin e paraqitur në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkuuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

19. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve

gjqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 25.05.2023, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet prej tij është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 22.12.2022. Nga materialet e çështjes ka rezultuar se kërkuesi në datën 26.01.2023 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me shkresë, sipas së cilës ka kërkuar zbardhjen e vendimit. Kancelari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. 629/1 prot., datë 06.03.2023, i ka dërguar kërkuesit në IEVP-në, Fier vendimin e arsyetuar. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

21. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës për t’u njoftuar, për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, pretendime të cilat *prima facie* hyjnë në kompetencën e Gjykatës. Duke mbajtur në konsideratë se argumenti kryesor i këtyre pretendimeve lidhet me procesin gjyqësor penal të zhvilluar në Itali, verifikimi i rregullshmërisë së të cilit ka qenë objekt i gjykimit të zhvilluar në Shqipëri, Kolegji do t’i analizojë nën këndvështrimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka parashtruar se vetëm gjatë gjykimit të një prej çështjeve penale të zhvilluara në ngarkim të tij, ajo e përfunduar me vendimin nr. 2821, datë 07.10.2013 të Gjykatës së Apelit Firenze, është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor. Pretendimet janë të lidhura me cenimin e së drejtës për t’u njoftuar, për t’u dëgjuar dhe mbrojtur gjatë gjykimit të kësaj çështjeje në gjykatat italiane. Gjatë gjykimit të çështjes si organet gjyqësore italiane, ashtu edhe ato shqiptare nuk kanë provuar marrjen dijeni të kërkuesit për procedimin penal, gjykimin dhe dënimin e tij nga gjykatat italiane.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë*

20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kolegji thekson se detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa i takon procesit me objekt njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të huaja, të parashikuar në nenet 512 e vijues të KPP-së, gjykata që shqyrton kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal nuk gjykon çështjen në themel, por verifikon nëse vendimi i huaj plotëson kushtet e njohjes të përcaktuara në nenin 514 të KPP-së. Nëpërmjet procedurave gjyqësore realizohet njohja e vendimeve penale të gjykatave të huaja, si dhe caktohet dënimi që do të vuajë i dënuari në shtetin pritës. Duke shqyrtuar përmbajtjen e konventave dhe të dispozitave procedurale penale, procedurat e mësipërme nuk përbëjnë shqyrtimin në themel të çështjes, por një shqyrtim gjyqësor të veçantë, ku duhet të zbatohen një sërë principesh themelore të gjykimit. Në këtë fazë, gjykata shqyrton nëse ekzistojnë ose jo kushtet e njohjes, parashikuar nga neni 514 i KPP-së dhe cakton dënimin që duhet të vuhet në përputhje me legjislacionin

shqiptar për të njëjtin fakt të pranuar nga gjykata e huaj (*shih vendimet nr. 35, datë 01.06.2015; nr. 6, datë 30.03.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se në zbatim të nenit 512 të KPP-së, bazuar në vendimin nr. 211/2014 të Gjykatës së Apelit Firenze (Itali), gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shqiptar kanë bërë njohjen e këtij vendimi duke bashkuar tre vendimet gjyqësore penale të formës së prerë, sipas të cilave është dënuar kërkuesi. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat kanë respektuar kërkesat e neneve 512, 513 dhe 514 të KPP-së. Kërkesa e prokurorisë shqiptare për njohjen e vendimeve të dhëna nga gjykatat italiane është shoqëruar me një kopje të vendimit të dënimit me burgim, ku janë paraqitur të plota të dhënat personale të kërkuesit. Veprat penale për të cilat është dënuar kërkuesi parashikohen edhe nga legjislacioni penal shqiptar dhe nuk rezulton që ai të jetë dënuar për këto vepra penale në Shqipëri. Gjithashtu, nuk ka rezultuar që vendimet e gjykatave të huaja të jenë ndikuar nga elemente diskriminuese, si raca, gjinia, feja, gjuha ose bindjet politike.

28. Gjykatat kanë arsyetuar se kërkuesi është dënuar në shtetin italian për tre vepra penale nga dy gjykata të ndryshme, përkatësisht, nga Gjykata e Arezzos, Itali në vitin 2005 për veprën penale “Largimi nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm”; nga Gjykata e Apelit Firenze në vitin 2009 për veprën penale “Prodhimi, trafikimi dhe mbajtja e paligjshme e lëndëve narkotike ose psikotrope”; përsëri nga Gjykata e Apelit Firenze për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve”. Këto vepra penale i korrespondojnë dhe përputhen me veprat penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, të parashikuar nga neni 323, paragrafi i parë, i Kodit Penal shqiptar; “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i Kodit Penal shqiptar; “Rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit”, të parashikuar nga neni 109, paragrafi i parë, i Kodit Penal shqiptar; “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i Kodit Penal shqiptar. Në legjislacionin penal material shqiptar këto vepra penale janë të parashikuara në dispozita të veçanta, pasi kanë elemente të ndryshme të anës objektive dhe subjektive dhe, si të tilla, dënojnë sjellje të ndryshme kriminale.

29. Në lidhje me përcaktimin e masës së dënimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shqiptar në rrethanat kur për këto vepra penale sipas Kodit Penal italian parashikohet një marzh dënimi në minimum dhe maksimum më i lartë sesa në Kodin Penal shqiptar, bazuar në nenin 11, shkronja “d”, të konventës “Për transferimin e personave të dënuar”, nenin 44 të konventës së Hagës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqësorëve penale”, si dhe nenin 516 të KPP-së

shqiptar, ka vendosur zbatimin e Kodit Penal shqiptar. Gjatë të procesit gjyqësor për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj kërkuar ka qenë i pranishëm dhe i përfaqësuar me avokat.

30. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit për njohjen e vendimit të huaj i plotësojnë standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

31. Në lidhje me pretendimin se kërkuar nuk është njoftuar nga gjykatat italiane për procesin penal të vitit 2013 dhe se nuk i është krijuar mundësia për të realizuar mbrojtjen, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm shqiptar, gjatë procesit gjyqësor për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të huaj, e kanë marrë në shqyrtim. Gjykatat kanë arsyetuar se këto pretendime mbeten në trajtën e kundërshtimeve, të paprovuara sipas formës së kërkuar nga marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushe dhe sipas legjislacionit procedural penal shqiptar, si dhe se kërkuar e mbrojtësi i tij nuk kanë paraqitur prova në lidhje me përmbajtjen e dosjes gjyqësore përkatëse, të cilat lidhen me gjykimin në mungesë dhe iniciativën ligjore përkatëse të ndërmarrë nga ai në lidhje me këto pretendime, të cilat duhet t'i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor të shtetit italian *(shih faqen 16 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe faqen 14 të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë)*.

32. Në përputhje me standardet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë procesit gjyqësor për njohjen e vendimit të huaj, Kolegji vlerëson se nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues debati mbi rrethanat faktike të kryerjes së veprës penale, të provuarit ose jo të veprës penale dhe se interpretimi i ligjit është në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, ndaj pretendimet e kërkuarit janë haptazi të pabazuara.

33. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.